

## **PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Studim Projektim" Furnizimi me ujë i fshatrave Goricaj, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolate,,Gradisht,Fier Seman,Gungas, Babunje, Babubje e re ne Njesine Gradisht".**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79415200-8 Shërbime të konsulencës në projektim**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 19,276,300** *(nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind) lekë pa tvsh.*

Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit , sipas shkreses se , Agjensia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, ku AKUM ka planifikuar objektin: miratuar Furnizimi me ujë i fshatrave Goricaj, Sopez, Senesa, Ferras, Mërtish, Këmishtaj, Spolate, Gradishte, Fier Seman, Gungas, Babunje, Babunje e re ne njesinë Gradisht”, ne vlerat Buxheti per 2023: 9,252,624 lekë me tvsh dhe Buxheti 2024:13,878,936 lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Lushnjë Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83” Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me Përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

#### **Sipas shtojces 11**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure eshte ”Sherbim Konsulence”, përcaktimi i vlerës së kërkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ku percaktohet se: ”40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 ”Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet*

*financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesi kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021, 2022) të paraqitura në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, ku te paktën në dy bilancet të njepasnjeshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.***

- a) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit ushtrimore 2020, 2021, 2022, vlera mesatare e të cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit pa TVSH.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është "Shërbim Konsulence", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: "40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim konsulence", si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

- b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, germa d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë sa 40% e fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

*Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me entet publike, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me entin publik, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.ose
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese të shitjes (*ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara*).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 30% të fondit limit.

---

**Shënim:** *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

### **2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:**

**Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:**

- **3 a,** Objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet b/a deri në 5 kate.
- **4 c,** Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- **4 j,** Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale
- **5 b,** Projektim Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.
- **5 c,** Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.

- **5 d,** Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.
- **6 a,** Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- **8 a,** Rivelime inxhinierike.
- **8 e,** Projektim fotogrametrik dhe hartografik.
- **9a** Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate.
- **9 e,** Studime e projektme hidrogjeologjike.
- **10 c,** Projektim impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj.
- **12 c,** Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. **Ofertuesit duhet te sjellin Licencat e rinovuara ne zbatim te ketij vendimi.***

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjisllacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

<i>KATEGORIA E KËRKUAR</i>	<i>PËRSHKRIMI I KATEGORISË</i>	<i>ARGUMENTIMI</i>
<b>3 – a</b>	Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	Bazuar në detyrën e projektimit, parashikohet realizimi i punimeve civile ne depo, puseta B/A, kalime urash etj., si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>4 – c</b>	Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.	Bazuar në detyrën e projektimit, projektuesi duhet te beje projektin elektrik te pompave dhe ndricimit te depove gjithashtu edhe pergjate trasimit te linjave duhet te konsiderohen edhe sistemet ekzistuese te linjave elektrike, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>4 – j</b>	Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale	Bazuar në detyrën e projektimit, projektuesi duhet te beje projektin e monitorimit te zonave te rendesise se vecante (depo e ujit, nëpërmjet kamerave dhe transmetimin e te dhëna ve online, si dhe monitorimin e matesave te ujit) dhe lajmerimin e rasteve te vandalizimit nepermjet sistemve te telekomunikacionit, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuaraa.
<b>5 – b</b>	Projektim Furnizim me ujë –kolektorë shkarkimi.	Bazuar në detyrën e projektimit, parashikohet realizimi i sistemit te furnizimit me uje te zonave urbane dhe rurale, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>5 – c</b>	Projektim ujësjellës kanalizime urbane – rurale.	Bazuar në detyrën e projektimit, parashikohet realizimi i sistemit te furnizimit me uje te zonave urbane dhe rurale, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>5 – d</b>	Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.	Bazuar në detyrën e projektimit, parashikohet realizimi i sistemit te furnizimit me uje te zonave urbane dhe rurale, projektuesi duhet te kujdeset qe linjat e furnizimit me uje te cilat do te kalojne ne sistemet e ujitejs dhe kullimit te jene konform rregullave dhe kushteve te projektimit te tyre, ai duhet te kete njohuritë e duhura ne kete disipline si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.

<b>6 – a</b>	Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.	Bazuar në detyrën e projektimit, parashikohet realizimi i kalimit të linjave në rrugët lokale dhe rurale dhe urbane dytësore dhe aksesit të tij me sistemin ekzistues rrugor, Gjithashtu konsulenti duhet të përgatis edhe planin e menaxhimit të trafikut gjatë punimeve në rrugë për hapjen e linjave të ujësullësive si rrjedhje gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>8 – a</b>	Rilevime inxhinierike	Bazuar në detyrën e projektimit, projektuesi duhet të bëjë azhurnimin e rrugës dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë linja e furnizimit me ujë, të jepet plani i piktimit dhe verifikimi paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhje gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>8 – e</b>	Projektim fotogrametrik dhe hartografik.	Bazuar në detyrën e projektimit, projektuesi duhet të bëjë skanimin me lidar dhe krijimin e hartave të perditesuar me saktësi të lartë (ortofotot dhe DTM) për saktësinë e të dhënave ekzistuese, përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhje gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>9 – a</b>	Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate <i>ne detyrën e projektimit në rubriken kërkesat që duhet të zgjidhet projekti pika 14</i>	Bazuar në detyrën e projektimit, projektuesi duhet të bëjë studime gjeologjike të trojeve dhe shpatëve me qendrueshmeri të ulet, në zonat e depove të reja përpara fillimit të projektit të zbatimit si rrjedhje gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>9 – e</b>	Studime e projekte hidrogjeologjike.	Bazuar në detyrën e projektimit, projektuesi duhet të bëjë studime hidrogjeologjike të zonës së burimeve përpara fillimit të projektit të zbatimit, si rrjedhje gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
<b>10 – c</b>	Projektim impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj	Bazuar në detyrën e projektimit, projektuesi duhet të bëjë projektin elektrik të pompave dhe ndricimit të depove gjithashtu edhe furnizimin me energji elektrike nga sisteme të tjera të furnizimit me energji të rinovueshme siç është ajo e PV, si rrjedhje gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.



<b>12 – c</b>	Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.	Bazuar në detyrën e projektimit, projektuesi duhet të beje projektin e linjave të furnizimit me ujë në rrugë, ura, për të qene të sigurt në llogaritjet statike dhe dinamike të tyre atë që duhet studimi sizmik i truallit, si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
---------------	--	--

**2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë Drejtuesit Teknikë të Përfshirë në Licencën e Shoqërisë, të paraqese Licencat profesionale të drejtuesve teknik, përgjegjës për zbatimin e kontratës në kategoritë si më poshtë shënuar, shoqeruar me Diplomë, CV dhe kontratat individuale të punës (të vlefshme),:**

- **1(nje) Projektues Inxhinier Ndertimi** me kat, **3/a** (Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- **1 (nje) Projektues inxhinier Ndertimi drejtimi Transport** me kat, **6/a** (Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore)
- **1(nje) Projektues inxhinier Hidroteknik** me kat, **5/b** Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi, **5/c** projektim ujesjelles kanalizime urbane-rurale, **5/d** Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.
- **1(nje) inxhinier Gjeodet** me kat, **8 a, e** (Rilevime inxhinierike dhe Projektim fotogrametrik dhe hartografik).
- **1 (nje) Projektues inxhinier Elektrik** me kat, **4/c** Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. **10/c** Impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, diellore, era etj.
- **1 (nje) Projektues inxhinier Radio Elektronik ose Elektronik** me kat, **4/j** Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale
- **1(nje) Projektues gjeolog** me kat, **9/a** (Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate, dhe **9/e** (Studime e projekte hidrogjeologjike)

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

- Punimet për shërbimin e projekteve strukturore kanë gjithashtu një volum të rëndësishëm, pasi kryesisht parashikohet të kemi realizim të objekteve me shkallë të ndryshme vështirësie të cilat kërkojnë gjykim dhe punime të specializuara në fushën e projektimit strukturor gjithashtu për këto kërkohet dhe staf ndihmes. Inxhinieri i ndërtimit do të duhet dhe në projektimin e nderhyrjeve të reja si rrjedhojë gjykohet që duhet të paktën **2 (dy) projektues inxhinier ndërtimi ndihmes**, pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit hidroteknik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve. Si rrjedhojë gjykohet e nevojshme prezenca e të paktën **1 (nje) hidroteknik** si pjesë e stafit teknik kryesor dhe **2 (dy) projektues inxhinier hidroteknik ndihmes**, pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit topografik do të jenë një zë i rëndësishëm në realizimin e projekteve që parashikohen të kenë dhe volume të konsiderueshme të punimeve topografike dhe krijimin e ortoimazherise si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (nje) gjeodet kryesor dhe 1 (nje) gjeodet ndihmes** si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të studimit gjeologjik parashikohen bazuar në termat e referencës, gjithashtu duhet të bëhet edhe vlerësimi i sasive së ujit në burimet aktuale, si rrjedhojë gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (nje) inxhinier gjeolog**, si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të planeve të sistemit të shesheve në depot e ujit, kalimet e linjave të furnizimit me ujë në zonat urbane të parashikuara këtu bazuar edhe në termat e referencës, gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (nje) arkitekti**, si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e kontrollit dhe projektimit të sistemit të pompave në stacionet e pompave, ndërtimin e depove të rezervimit të ujit, kalimin e linjave të mundshme elektrike nëntoksore dhe vlerësimin e tyre gjatë projektimit, gjykohet si e nevojshme prezenca e të paktën **1 (nje) Projektues inxhinier Elektrik**, si pjesë e stafit teknik.
- Punimet për shërbimin e projektimit të sistemit të sigurisë dhe monitorimit nëpërmjet instalimit të sistemit të kamerave në zonat e stacionit të pompave dhe në depot e rezervimit të ujit, si dhe krijimi i mundësive për pikat kyçe të rrjetit për vendosjen e sensoreve për monitorim në kohe reale të parametrave hidraulikë siç janë presioni dhe

prurja ne ate pike, gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) Projektues inxhinier Radio Elektronik te diplomuar para viteve 1980 ose Eletronik**, si pjese e stafit teknik.

- Punimet per sherbimin e projektimit te pompave, monitorimit dhe vleresimit te tyre per te siguruar prurjet e nevojshme sipas termeve te references. Pra nga puset ne drejtim te depos kryesore, gjykohet si e nevojshme prezenca e te pakten **1 (nje) Projektues inxhinier Mekanik**, si pjese e stafit teknik.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë CV-të e tyre, nje pershkrim i pergjithshem i profilit te veprimtarise perkatese, te dhena te pergjithshme lidhur me eksperienca dhe bashkepunime, ne permbushje te projekteve te ndryshme me natyre konsulence, ne fushen e projektimit.

**Argumentim:** Me ane te permbushjes se ketij kriteri Operatori ekonomik ben nje pasqyrim te te gjithë veprimtarise dhe punes se tij. E cila e ben me te besueshme ne permbushjen e sherbimit qe do te realizohet.

**2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të ketë Staf Ndhmës si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) Muajve të Fundit (Korrik 2023-Shtator 2023) ose Persona Fizik (PF) me kontrate qe garantojne disponueshmerine per kete projekt sipas afateve te paracaktuara ne keto terma reference:**

- 2 (dy) Inxhinier Ndertimi
- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) inxhinier Gjeodet.
- 1 (nje) inxhinier Elektrik.
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Ekspert mjedisor për hartimin e VNM

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

***Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7)***

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të Referencës për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Gjithashtu si pjese e stafit ndihmes te ekipit kerkohet te jete minimalisht 1 (nje) Inxhinier Elektrik, 1 (nje) Inxhinier Mekanik, 1 (nje) Ekspert Mjedisi, 1 (nje) Inxhinier Gjeodet.

Inxhinieri Elektrik kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me llogaritjet per percaktimin e furnizimit me energji te paisjeve te pompave ekzistuese ose te reja, te matesave elektromagnetike te matjes se prurjeve te ujit neper zonimet e rrjetit, kordinimin e informacionit me operatorin e shperndarjes se energjise etj.

Inxhinieri Mekanik kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me percaktimin e paisjeve te nevojshme dhe tipin e bashkimit per nyjet hidraulike perfshire saracineskat, matesat e medhenj, matesat individuale te konsumatoreve etj.

Ekspert Mjedisit kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me pergatitjen e raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis sipas legjislacionit mjedisor ne fuqi.

Inxhinieri Gjeodet kerkohet per realizimin e sherbimeve te lidhura kryesisht me pergatitjen e studimit topografik te zonave ku do te kalojne rrjetet e ujesjellesit me qellim percaktimin e kuotes se projektit dhe pergatitjen e profilave topografike gjatesore dhe terthore si dhe percaktimin e volumeve te germimeve dhe mbushjes.

**2.3.5 Operatori ekonomik duhet të kenë në Stafin e Shoqërisë Personel të kualifikuar/certifikuar si:**

- a) 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Diplome/certificate.

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazës së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

*Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë (shtojca 7)*

**Argumentimi: Ekspert mjedisor për hartimin e VNM** është i nevojshëm për hartimin e raportit të Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit dhe termave të referencës.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje me Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar në pikën 18 të nenit 6 të të cilit është është parashikuar se: “*Ekspert i certifikuar i VNM-së*” është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor dhe pikën 3 të nenit 6 të këtij ligji është parashikuar se: “*Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)*” është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:

- a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;
- b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;
- c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;
- ç) përfundimit të arritur, të arsyetuar nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;
- d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent.”

**2.3.6 Një punësim mesatar i të paktën 15 (pesmbledhete) personave, për periudhën e 3 (tre muajve te fundit)** të vërtetuar me;

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen
- b) Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen 3 muajve te fundit .

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

### **2.3.7 Operoret Ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, ose ekuivalenten e tyre përfshirë:**

Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertifikate **ISO 9001 -2015** (e vlefshme) për menaxhimin e cilësisë lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim. (Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

b) Operatori Ekonomik duhet të zotërojë dhe të paraqesë një çertifikate **ISO 14001-2015** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 45001-2018** (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim (Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

**Argumentim:** Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

Operatori ekonomik duhet te kete nje person pjese e stafit te tij i licensusuar per VNM

**2.3.8.** Operatori Ekonomik duhet te jete licensusuar nga Q.K.L. per “Sherbime ekspertize ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”

Për të përmbushur kriteret e sipërcituara, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimit elektronik, licencat e mësipërme.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kane kualifikimet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës referuar detyres se projektimit, natyres se pergjithshme te sherbimeve qe priten te ofrohen, operatoret ekonomike duhet te kene licencat perkatese.

**2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponoje mjetet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates.**

Në funksion të zbatimit te kontrates, kërkohet të jenë në dispozicion:

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi duhet të përdorë programet e duhura kompjuterike, si dhe inkurajohet për përdorimin e programeve të reja të cilat sigurojnë lexueshmëri dhe saktësi në projekt. Operatori ekonomik duhet të zotëroje dhe dëshmojë që ka kapacitet e duhura nga ana inxhinierike dhe Teknike (software-t/programet e nevojshme si: AutoCAD, ArcGIS Desktop, OpenFlows WaterGEMS, etj. ne fushën e ujerave.)

Për nevoja të rilevimit topografik dhe krijimin e ortofotove me saktësi dhe shpejtesi duke ju pergjigjur fazave te projektit, duhet te deshmoj dhe zoteroje kapacitet e duhura ne skanimin ajeror me lidar. Saktësia e lidarit kerkohe te jete minimalisht 3cm ne 100m lartesi, kurse rezulucioni efektiv i kameras te jete minimum 45 MP dhe saktësia absolute e saj te jete 3cm horizontale dhe 5 cm vertikale.

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet të paraqese:

- a) Per pajisjet operatori ekonomik duhet te paraqesi dokumentat qe vertetojne pronesine e tyre, apo marrjen me qira te tij si psh: ***Fature tatimore te shitblerjes ose kontrate qiraje te noterizuar.***
- b) Per software-t/programet kompjuterike operatori ekonomik duhet te paraqesi dokumentat qe vertetojne pronesine e tyre, si psh: ***Fature tatimore te shitblerjes.***
- c) *Per mjete qe shenohen ne regjistrat publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton **regjistrimin e mjetit/ certifikate pronesie, siguracionin e mjetit, certifikaten e kontrollit teknik, leje perdorimi, leje qarkullimi.***
- d) *Per mjetet e siguruara me qira, dokumentat e mesiperme duhet te shoqerohen edhe me kontraten perkatese noteiale te qirase/leasing/huaperdorjes e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet paraqesë CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

**Argumentim:** Me ane te permbushjes se ketij kriteri Operatori ekonomik ben nje pasqyrim te te gjithë veprimtrise dhe punes se tij, e cila e ben me te besueshme ne permbushjen e sherbimit qe do te realizohet.

**2.3.11** Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” i azhornuar.

**Argumentim:** Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit*



*publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*